

**VENDIM**  
**Nr. 723, datë 2.9.2015**

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA  
GJIROKASTËR, TË SIPËRFAQES TRUALL FUNKSIONAL, BRENDA  
TERRITORIT TË PRONËS NR. 593, ME EMËRTIM “SHTABI I BRIGADËS”, ME  
VENDNDODHJE NË GREHOT, GJIROKASTËR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË  
VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME  
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI  
MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Gjirokastrë, të truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 1 544 (një mijë e pesëqind e dyzet e katër) m<sup>2</sup>, brenda territorit të pronës nr. 593, me emërtim “Shtabi i Brigadës”, me vendndodhje në Grehot, Gjirokastrë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për nevoja urbanistike, për projektin e ndërtimit të rrugës publike “Rikonstruksion i rrugës nacionale dhe ndërtimi i shëtitores Varrezat e Dëshmorëve–Virua”, në Gjirokastrë.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, sipërfaqja truall, prej 1 544 (një mijë e pesëqind e dyzet e katër) m<sup>2</sup>, të hiqet nga truall funksional i pronës nr. 593, me emërtim “Shtabi i Brigadës”, me vendndodhje në Grehot, Gjirokastrë, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit urban të transportit publik, rrugë publike, që i janë transferuar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Gjirokastrë.

3. Bashkisë Gjirokastrë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të sipërfaqes truall funksional, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Para fillimit të punimeve, Bashkia Gjirokastrë të ndërtojë rrethimin në kufijtë e rinj të pronës, të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e rrugës, sipas parametrave dhe kushteve teknike, duke i kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme, dhe, për këtë qëllim, ndërmjet Bashkisë Gjirokastrë dhe Komandës Mbështetëse, Tiranë, të hartohet një aktmarrëveshje.

5. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**